



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 6962 prot.

Shkodër, më 01.04. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin: **PËR DHËNIE PËLQIMI, SHTESA DHE NDRYSHIME PËR SHOQËRINË AKSIONARE „BIO STRAJCA”, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR.**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. 6962/Prot

Shkodër, më 01 04.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.2025

PËR

**DHËNIE PËLQIMI, SHTESA DHE NDRYSHIME PËR SHOQËRINË AKSIONARE
“BIO STRAJCA”, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR.**


Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____.prot, datë _____ të administratës së bashkisë Shkodër, me propozim të kryetarit të bashkisë Shkodër:

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për ndryshimin e emrit dhe logos të shoqërisë Bio Strajca krijuar me VKB nr. 15, datë 20.07.2023, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë dhënien e pëlqimit për shtimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, si vijon:
 - Në objektin e veprimtarisë së shoqërisë aksionare, pas germës c shtohen germat
 - ç. Administrimi/Menaxhimi i plazheve publike të menaxhueshme dhe aktivitetet e stacionit të plazhit
 - d. Ofrimi i shërbimeve dhe produkteve turistike e kulturore.
 - e. Aktivitetet e operatorit turistik dhe operatorit të turizmit detar .
 - f. Aktiviteteve të agjentëve, ndërmjetësve për qiradhënien dhe tregtinë për dhe në vendet e ofrimit dhe organizimit të shfaqjeve koncerteve apo eventeve të ndryshme.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Shkodër për ndjekjen e të gjitha procedurave në vijim dhe kryerjen e të gjitha ndryshimeve dhe veprimeve të nevojshme, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI



Zv. Kryetar

Alban Bekteshi

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Belkum Memeti

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Mbështetëse

Seni Dusha

Drejtoria e Juridike

B. Zeqirja

Drejtoria e Turizmit

Renato duogji

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mandesha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK

Nr _____ prot.

Shkodër, me ____ . ____ .2025

RELACION

PËR DHËNIE PËLQIMI, SHTESA DHE NDRYSHIME PËR SHOQËRINË AKSIONARE ,“BIO STRAJCA”, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar Këshilltarë!

Përmes VKB nr. 15 “Për krijimin e shoqërisë aksionare „Bio Strajca” , sh.a, si person juridik në pronësi të bashkisë shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit, të vitit 2023 Bashkia Shkodër dhe Këshilli Bashkiak kanë themeluar shoqërinë aksionare me objekt kryesor menaxhimin dhe administrimin e tregjeve publike të Bashkisë. Sh.a. e cila tashmë me përfundimin e punimeve në tregun e rusit, por edhe me ndërhyrje të vogla në qytet, po bën hapat e saj drejt një performance të mirë administrative dhe financiare.

Kjo strukturë e organizuar në formë Sh.a. krijon mundësinë e administrimit më efikas të disa aseteve apo punëve të Bashkisë Shkodër duke arritur që të ketë të ardhura të vazhdueshme dhe rikthim të këtyre të ardhurave në investimet të tjera në territor. Territori i Bashkisë Shkodër ofron mundësi të shumta për zhvillim ekonomik dhe turistik e kulturor. Të gjithë këto zona, si Shkodra, Dukagjini, Postriba, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdica, Dajci dhe Velipoja, kanë potenciale të jashtëzakonshme për zhvillim, duke ofruar mundësi për një qasje më të organizuar dhe strategjike ndaj menaxhimit të këtyre resurseve. Synimi kryesor është ofrimi i shërbimeve publike që do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, duke përfshirë:

Zhvillimin e turizmit: Përdorimi i burimeve natyrore, historike dhe kulturore të Shkodrës për të rritur ofertën turistike. Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve do të tërheqë vizitorë dhe do të nxisë rritjen e të ardhurave dhe investimeve.

Produkte kulturore dhe turistike: Krijimi i mundësive për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që përfshijnë traditat, artizanatin dhe kulturën e pasur të Shkodrës, si dhe aktivitete që lidhin vizitorët me traditat lokale.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Të gjitha këto aktivitete do të mbështesin zhvillimin ekonomik dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet lokale, duke krijuar mundësi punësimi dhe përmirësuar shërbimet publike për qytetarët e vizitorët.

Ky është një proces që kërkon bashkëpunim ndërmjet institucioneve, komunitetit dhe sektorëve të ndryshëm, si dhe angazhim të strukturave pronë 100% të Bashkisë Shkodër për të menaxhuar dhe administruar këto mundësi në forma alternative e më pak burokratike për të maksimizuar potencialin dhe për të arritur zhvillim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm.

Ndryshimet e fundit ligjore përkatësisht VKM nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i japin të drejtën Njësive të Vetëqeverisjes Vendore që të bejnë Administrimin/Menaxhimin e stacioneve të plazheve për të cilat nuk është lidhur kontratë me operator privat. Jo vetëm menaxhimi i plazheve por edhe menaxhimi i resurseve apo asetëve të tjera, ofrimi i shërbimeve të ndryshme turistike e kulturore dhe ekonomizimi i tyre do të jetë një mundësi e mirë për bashkinë Shkodër, për të ofruar shërbime dhe produkte sipas standardeve duke krijuar të ardhura.

Duke qënë se Sh.a. ekzistuese projektohet të ketë shtim të fushës së veprimtarisë edhe në sektorin turistik apo kulturorë, propozojmë që të kemi një emërtim të ri më gjithëpërfshirës. “Skodrinon” është një emërtim që lind në antikitetin e qytetit të Shkodrës i cili gjendet në monedhat e para të emetuara në rajonin tonë, duke përfaqësuar një element tregues të rëndësishëm të ekonomisë, dhe tregtisë që ka pasur Shkodra, në vitet e kaluara, si qëndër rajonale. Prandaj propozohet ky emërtim i ri i cili do të jetë edhe marka (brandi) i veprimtarive që do të zhvillojë Sh.a. në fushat e aktivitetit të saj.

Sa më sipër në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,; ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, propozohet që:

Të jepet pëlqimi për ndryshimin e emrit dhe logos të shoqërisë Bio Strajca krijuar me VKB nr. 15, datë 20.07.2023, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur.

Të jepet pëlqimi për shtimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, si vijon:

- Në objektin e veprimtarisë së shoqërisë aksionare, pas germës c shtohen germat
 - ç. Administrimi/Menaxhimi i plazheve publike të menaxhueshme dhe aktivitetet e stacionit të plazhit
 - d. Ofrimi i shërbimeve dhe produkteve turistike e kulturore.
 - e. Aktivitetet e operatorit turistik dhe operatorit te turizmit detar .
 - f. Aktiviteteve të agentëve, ndërmjetësve për qiradhënien dhe tregtinë për dhe në vendet e ofrimit dhe organizimit të shfaqjeve koncerteve apo eventeve të ndryshme.

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Bener BECI



Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Bekim Hama

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Marduska

Drejtorja e Turizmit

Renato Dumçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

ANEKSI I

1. Emri i Shoqërisë Aksionere

Ishte:

Bio Strajca Sh.a.

Bëhet:

“SKODRINON” Sh.a.

2. Logoja e Shoqërisë Aksionere

Ishte



Bëhet:

